




Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë
Odeljenje za Osiguranje Kvaliteta / Division for Quality Assurance

Raport i përgjithshëm i identifikimit të sfidave gjatë pandemisë COVID-19



Lista e shkurtesave

- IAL: Institucion i Arsimit të Lartë
- AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike
- FSP: Fakulteti i Sigurisë Publike
- ISP: Institucionet e Sigurisë Publike
- KD: Këshilli Drejtues
- AKK: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
- PK: Polica e Kosovës
- IPK: Inspektorati Policor i Kosovës
- AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent
- SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës
- SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës
- DK: Doganat e Kosovës
- DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë
- SMU: Sistemi i Menaxhimit Universitar
- DTI: Divizioni i Teknologjisë Informative

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	2
Përmbledhje ekzekutive	4
Hyrja	5
Realizimi i pyetësorit	5
Të gjeturat e pyetësorit.....	6
RAPORT I VLERËSIMIT	7
Sfidat e identifikuar.....	9
Përparësitë e identifikuar.....	11
Komentet e përmbledhura.....	12
Rekomandimet	13

Përmbledhje ekzekutive

Pandemia COVID-19 edhe njëherë konfirmoj se ka qenë dhe mbetet sfidë për funksionin dhe alterimin e pikëpamjes operative për të gjitha institucionet e sigurisë publike në mbarë botën, përfshirë edhe Kosovën. Ajo çka e karakterizoj pandeminë COVID 19 ishte ndikimi në funksionimin e institucioneve të sigurisë publike dhe kjo bëri që të gjithë të ngriten përtej të pamundurës.

Në gusht të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës e miratoi “Ligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës”, pasoj “Strategjia shtetërore për parandalimin, menaxhim dhe kontrollim të pandemisë COVID 19” e vitit 2021, “Manualin për mbrojtje nga përhapja e COVID-19”, “Planin shtetërore të vaksinimit kundër COVID 19”, udhëzues të ndryshëm që trajtonin qasjen, ofronin udhëzime gjerë tek ato të higjienës personale të cilat u bënë pjesë e kampanjave dhe njoftimeve në të gjitha institucionet shtetërore.

Në anën tjetër fusha e sigurisë publike si pjesa vitale ishte sfidë në vete duke testuar dhe ngritur nivelin e gatishmërie sidomos në fushën e ngritjes së kapaciteteve të sigurisë publike në vend si institucion i vetëm me mandat për të ofruar arsim të lartë dhe trajnime të validuara nga KD i AKK-së.

Gjatë pandemisë, AKSP ishte në pikun e kërkesave për aktivitetet trajnuese e arsimore të cilat ishin të planifikuara bazuar në analizën e nevojave për trajnim nga Institucionet e Sigurisë Publike. Përgjatë vitit 2019-2020 në AKSP trajnoheshin kadetët e rinjë të gjeneratës të 55-të në AKSP gjegjësisht trajnimi i tyre kishte filluar 11.11.2019, kurse me datë 12.03.2020 ishte ndërprerë në javën e 18 të trajnimit, me *Vendimin nr.01/07 te datës 11.03.2020 të Qeverisë të Republikës së Kosovës.*

Akademia në kuadër të përgatitjes për vazhdimin e aktivitetet të saja draftoi dokumente si: **“Plani për qeverisje të mirë në AKSP gjatë pandemisë”**, **“Plani për realizimin e trajnimit profesional "Polic i ri" online përmes platformës së mësimin në distance E-trajnimi”**. Kjo ngriti kapacitet trajnuese dhe rifunksionalizimin e sistemit online të platformës “Moodle” ku për një javë u trajnuan stafi trajnues dhe arsimor nga ana e zyrtarëve të DTI në AKSP dhe u funksionalizua platforma duke hapur llogari dhe ofruar qasje për **432 kadetë të rinj**.

Në analogji me institucionet tjera arsimore në Republikën e Kosovës, mësimdhënësit e Fakultetit të Sigurisë Publike kanë vazhduar të zhvillojnë mësimin nga distanca. Vazhdimi i procesit arsimor në Fakultetin e Sigurisë Publike, për **215 studentë të rregullt** të këtij fakulteti, ishte i njëjti me vazhdimin e procesit arsimor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Vitet 2021-2022 e gjetën AKSP më të përgaditur dhe me një mësim online të integruar dhe funksional gjithnjë në respektimin e masave dhe udhëzimeve për të gjitha ata që ndiqnin aktivitetet të natyrave trajnuese e arsimore në AKSP. Përgjatë kësaj periudhe kohore u mbajtën

dy konferenca hulumtuese të cilat trajtuan sfidat e pandemisë COVID-19 në sigurinë publike me një gamë të gjerë hulumtuesisht nga mbarë bota.

Hyrja

AKSP është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Akademia ofron shërbimet për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*

Sigurimi i cilësisë në AKSP - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në AKSP dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative. Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë.

Në muajin tetor të vitit 2022, në vazhdën e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda AKSP, me qëllim të identifikimit të sfidave dhe përmirësimit të vazhdueshëm, DSC-ja ka realizuar pyetësin elektronik mbi identifikimin e sfidave gjatë pandemisë COVID-19 në AKSP.

Realizimi i pyetësit

DSC në tetor të vitit 2022, ka lansuar pyetësin/anketën lidhur me sfidat që AKSP ka has gjatë pandemisë COVID-19. Pyetësi ka qenë anonim dhe i formatit elektronik i adresuar përmes platformës së domanit dsc.aksp@aksp-ks.org e cila njëherësh është e ndërlidhur me përpunimin e të dhënave elektronike duke shfrytëzuar sistemet e licencuara të google

forms. Respondetet janë përgjigjur përmes sistemit elektronik i cili në kuadër të një pyetësit për vlerësimin e performancës së AKSP në përballjen me sfidat e pandemisë COVID-19 ka përmbytur 15 pyetje të formatit komentues dhe analitik. Gjithsejt janë shpërndarë 52 pyetësor tek 52 respondent.

Të gjeturat e pyetësit

Pyetësorët elektronik të plotësuar nga e studentëve e FSP-së, stafit mësimdhënës dhe atë trajnues mbi sfidat e tyre në periudhën e pandemisë COVID-19 në AKSP është i bazuar në respondent të përzgjedhur nga fushat respektive. DSC ka bërë shpërndarjen elektronike të pyetësorve si dhe njoftimet paraprake dhe rikujtuese përmes sistemit elektronik. Gjegjësisht janë shpërndarë 52 pyetësor, kur prej tyre janë anketuar 20 student, 6 profesor, 10 zyrtar nga stafi civil i fushës së trajnimeve përfshirë instruktorë, trajnues dhe zyrtar të nivele të ndryshme si dhe 16 kadetë të trajnimit profesional, kurse totali i përgjigjeve të pranuar ka qenë gjithsejt 416 përgjigje të formatit vlerësues në përqindje dhe notë vlerësimi, kurse në aspektin koment ofruar kemi pranuar 364 komente e cila në total na jap numrin prej 780 reagimeve të ofruara nga respondentët në kuadër të pyetësit/anketës.

Të gjitha të gjeturat të cilat janë ofruar nga përgjigjet e respondentëve kanë qenë të dhëna të sinqerta të ofruara në vlerësim, koment dhe propozimet e tyre janë pjesë thelbësore në përmirësimin e vazhdueshëm në kuadër të proceseve në AKSP e sidomos në identifikimin e sfidave në ballafaqimin me COVID-19. Ky raport njëherësh shprehë statistikën e përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve në nivel të AKSP-së.

RAPORT I VLERËSIMIT

Objektivi: Objektivat e pyetësorit janë mbledhja e informatave kthyesë nga personeli lidhur me identifikimin e sfidave në organizimin, menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të AKSP gjatë pandemisë COVID-19.

Qëllimi: Me anë të këtij vlerësimi pritet të arrihet përmirësimi dhe sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë në sfidat e natyrave të ngjashme duke ndjekur shembullin e përmirësimit dhe aplikimit të mekanizmave përmirësues me qëllim të ngritjes së cilësisë.


Data e vlerësimit/anketës	<u>7/10/2022</u>
Nr. pyetësorëve të plotësuar:	52 respondent ose 100% e të anketuarve
Nr. i përgjithshëm i te anketuarve	52 pjesëmarrës në anketë

Kategorizimi i vlerësimit sipas % së fituar zbërthyer në notë vlerësimi

Nuk pajtohem aspak	0%-20%	nota e vlerësimit 1	<i>Sqarim:</i> Nota e vlerësimit 5 (pesë) përfaqëson vlerësim maksimal, ndërsa nota e vlerësimit 1 (një) përfaqëson vlerësimin minimal.
Nuk pajtohem	21%-40%	nota e vlerësimit 2	
Neutral	41%-60%	nota e vlerësimit 3	
Pajtohem	61%-80%	nota e vlerësimit 4	
Pajtohem plotësisht	81%-100%	nota e vlerësimit 5	

Nga vlerësimet e pranuar kemi këto të dhëna si në vijim:

Nuk pajtohem aspak	0	0%
Nuk pajtohem	0	0%
Neutral	37	9%
Pajtohem	308	74%
Pajtohem plotësisht	71	17%
total pergjigje	416	
Mesatarja e kenaqshmerise	81.6%	



ANALIZA E VLERAVE NUMERIKE TË FITUARA

Pyetet e pyetësorit		Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotesisht	mesatarja e kenaqshmerise	nota e vleresimit
Cili ishte niveli i ndikimit të pandemisë në zhvillimin e mësimit online?	Është shënuar ngritje e njohurive/kapaciteteve digjitale	0.00%	0.00%	17.31%	17.31%	65.38%	80.00%	4.00
	Ngritja e nivelit të të mësuarit analitik	0.00%	0.00%	19.23%	80.77%	0.00%	76.15%	3.81
	Ngritje të kapaciteteve pedagogjike të mësimit online	0.00%	0.00%	34.62%	65.38%	0.00%	73.08%	3.65
	Janë arritur shkëmbime virtuale dhe mësim online interaktiv	0.00%	0.00%	0.00%	80.77%	19.23%	83.85%	4.19
	Është jetësuar përdorimi i infrastrukturës digjitale për të komunikuar me student	0.00%	0.00%	0.00%	63.46%	36.54%	87.31%	4.37
Cili ishte niveli i institucionit tuaj në implementimin e mësimit online?	Institucioni ka ofruar qasje dhe mbështetje digjitale	0.00%	0.00%	0.00%	88.46%	11.54%	82.31%	4.12
	Institucioni posedon kapacitete teknike dhe logjistike (pajisje dhe platformë)	0.00%	0.00%	0.00%	82.69%	17.31%	83.46%	4.17
	Institucioni ka lehtësuar qasjen dhe ka ofruar mbështetje profesionale me IT	0.00%	0.00%	0.00%	65.38%	34.62%	86.92%	4.35
	Pjesa e internshipit ka qenë e lehtësuar (bazuar në masat mbrojtëse)	0.00%	17.31%	34.62%	30.77%	17.31%	69.62%	3.48
	Institucioni ka ofruar trajnime dhe udhëzime në kohë reale për zhvillimin e mësimit online	0.00%	0.00%	0.00%	82.69%	17.31%	83.46%	4.17

Sfidat e identifikuara

Në pyetësin tonë lidhur me identifikimin e sfidave, neve kemi parashtruar këtë pyetje:

Cilat ishin sfidat në organizimin, menaxhimin dhe koordinimin e mësimit online?


Këto janë komentet/informatat kthyesë të përmbledhura si në vijim:

- *Mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë ligjerues-pjesëmarrës gjatë trajnimit ku mungesa e komunikimit pamundëson punën në grupe më të vogla dhe komunikimin e drejtpërdrejtë,*
- *Praktikimi i njohurive në praktikë është pothuajse i pamundëshëm,*
- *Përgaditja dhe marrja e njohurive për zhvillimin e mësimit online si dhe mos realizimi i disa synimeve për shkak të kufizimit të elementeve përcjellëse teknike në disa raste,*

Përkundër mundësive në përdorimin e platformës “Moodle” e cila është donacion nga Projekti i Binjakëzimit, platforma në fushën e implementimit ishte lënë relativisht anash përkundër faktit që AKSP posedonte mekanizma qoftë teknik apo profesional për ngritjen e kapaciteteve në avancimin e mësimit online. Nga zyrtarët profesional të Divizionit të Teknologjisë Informatike, përkundër udhëzimeve të përgjithshme dhe atyre individuale në përdorimin e platformës online “Moodle” u sigurua edhe video-udhëzime e materiale në formë të detajuar që sqaronin përdorimin e kësaj platforme. E tëra kjo prodhoj një mori ngarkesash me orë të shtuara pune jashtë orari dhe krijimin e taskforcave vepruese në fushën e DTI. Gjithashtu edhe pas të gjitha përgaditjeve, fillimisht u bënë teste, standardizime të sistemit intranet dhe internet. Pastaj filluan monitorimet e analizimet e rrjetit dhe informatava kthyesë në fazën testuese.

Pas fazës testuese u ofruan trajnime, udhëzime dhe asistime në implementim për një familjarizim të stafit në përdorimin e platformës “Moodle”. Kjo edhe bëri që stafit trajnues dhe mësime të trajnohej në përdorimin e platformës, jo vetëm në modelin interface por edhe atë zbatues e operativ gjerë në ngarkimin e materialeve mësimore. Vleresimi kaloi në sistemin elektronik si dhe një pjesë e testimit. Poashtu u arrit që në arsimin e lartë të mbrohen edhe temat e diplomës përmes sistemit online, video-konferenca e gjerë tek krijimi i grupeve punuese të fushave të interesit përfshirë edhe ISP-të respektive.


Në pyetjen tonë;



Nga 52 të anektuar kemi këto të dhëna:

- **42** të anketuar ose **81%** e tyre janë përgjigjur se kanë pranuar trajnim nga AKSP, dhe
- **10** të anketuar ose **19%** e tyre janë përgjigjur se nuk kanë pranuar trajnim nga AKSP


Në pyetjen tonë;



Nga 52 të anektuar kemi këto të dhëna:

- **47** të anketuar ose **90%** e tyre janë përgjigjur se kanë pranuar material udhëzues nga AKSP, dhe
- **5** të anketuar ose **10%** e tyre janë përgjigjur se nuk kanë pranuar material udhëzues nga AKSP

Në pyetjen tonë;



Nga 52 të anektuar kemi këto të dhëna:

- 52 të anketuar ose 100% e tyre janë përgjigjur se kanë përdorur platformën “Moodle” për mësim online të ofruar në AKSP.

Sistemet e mësimin online janë pothuajse të pamundur të ofrojnë interaktivitet në fushën e trajnimeve ku kërkohet pjesa praktike e sidomos ajo e sigurisë publike, kur programet arsimore varen nga pjesa e internshipit. Që të arrihet sadopak një lehtësim për internship, AKSP ende nuk e ka të zhvilluar njësinë e multimedias për avancimin e sistemit online përmes videotekës-apo krijimit të bazës së të dhënave në formatin video dhe digjitalizimin e saj në tërësi.

Mbetet sfidë gjetja e formave të realizimit të praktikës në aktivitetet/trajnimet/kurset që kanë pjesën praktike – internshipin obligativ. Që të arrihet avancimi në mësimin online, AKSP duhet të parashih digjitalizimin e saj në total, sidomos në ngritjen e kapaciteteve njerëzore profesionale dhe asaj mbështetëse logjistike.

Përparësitë e identifikuar

Në pyetësorin tonë lidhur me identifikimin e përparësive, neve kemi parashtruar këtë pyetje:

Cilat ishin përparësit në organizimin, menaxhimin dhe koordinimin e mësimin online?

Këto janë komentet/informatat kthyesë të përmbledhura si në vijim:

- *Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike dhe avancimi në përdorimin e pajisjeve teknologjike të ligjeruesit.*
- *Ligjeruesit dhe pjesëmarrësit kanë komoditet që të qasen nga cili do vend, të marrin mësimet e tyre edhe pa qenë fizikisht prezent në klasë.*
- *Program dinamik i të mësuarit në mënyrë elektronike.*

Nga të dhënat për vitet 2019-2022 AKSP ka arritur të funksionalizoj 100% platformën e mësimit online duke kaluar në fusha të ndryshme të aplikimit si ligjeratat, ngarkimi i materialeve, vlerësimi dhe testimi e gjerë tek mbrojtja e temës së diplomës në FSP. Me sukses u trajnuan **52 trajnues të brendshëm të ISP-ve** dhe **10 trajnues/ekspertë të jashtëm** në AKSP dhe u hapen **432 llogari** për qasje në “moodle”, u ngarkuan më shumë **1000 materiale trajnuese** për **432 kadetë të rinj**.

Vlerësimi kaloi në sistemin online në tërësi, u zhvilluan teste si dhe u organizuan mbrojtje të temave të diplomave në FSP përmes sistemit online. U zhvilluan video konferenca dhe u krijuan grupe të interesit në akademi në fushën e menaxhimit, arsimit dhe logjistikës mbështetëse. Për **215 studentë të rregullt** të këtij fakulteti u hapën llogari nga domaini **aksp-ks.org**, u asistuan përgjatë fazave të ndryshme në ligjerata e gjerë tek diplomimi i studentëve përmes platformës online. Dinamika e zhvillimeve në AKSP u ngrit në nivelin të lartë përballë sfidave me pandeminë COVID-19 dhe ofruan mundësi të reja të cilat lehtësuan proceset arsimore në akademi.

Stafi i AKSP arriti të imunizohet përmes vaksinimit të **143 zyrtarve** me vaksinat anti-covid, kurse përpos ligjeratave nga Sektori i mjekësisë mbi vetëdijësimin e ruajtjes së mireqenijes së zyrtarëve dhe pjesëmarrësve në proces të arsimit, kampusi i akademisë ngriti nivelin e gatishmërisë në përballjen me COVID-19 përmes kontrollit, monitorimit dhe implementimit të vendimeve dhe rekomandimeve të IKSHPK-së dhe MSH-së.

Komentet e përmbledhura

Këto janë komentet/informatat kthyesë të përmbledhura si në vijim:

- *Duke pasur parasysh situatën me pandeminë globale COVID-19, AKSP si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike, është e rëndësishme të i avancojë burimet njerëzore si dhe paisjet e teknologjisë informative të cilat do të përdoren në të ardhmen për realizimin e kurseve/trajnimeve online;*
- *Qasja në Platformen Online është mundësi e shkëlqyer që të zhvillohemi profesionalisht pa qenë të obliguar të jemi fizikisht në Akademi, kjo mundësi duhet të shfrytëzohet për trajnime teorike edhe në kohë post pandemike;*
- *Nuk preferoj zhvillimin e mësimit online sepse nuk është mjaftueshëm efektiv dhe konsideroj se mësimi i zhvilluar me prani fizike është shumë më efektiv;*
- *Ky është një hap i rëndësishëm rreth ofrimit të mundësisë për vazhdimin e mësimit në një formë ndryshe nga ajo më të cilën jemi mësuar;*
- *Mësimi online në kohë të ndryshme e sidomos tash është një sfidë e re dhe një përvojë shumë e mire;*

Rekomandimet

Divizioni për sigurimin e cilësisë në AKSP, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet nga respondent dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të AKSP që të merren hapat si më poshtë:

- *AKSP inkurajohen të eksplorojnë avancimet e sistemeve dhe njëkohësisht avancimit të mjedisit arsimor duke iu përshtatur të nxëniet virtual përmes mësimit online;*
- *Të investohet vazhdimisht në trajnime të personelit të akademisë në platformat e ndryshme të mësimit online me theks të veçantë asaj “Moodle” që AKSP ka në përdorim, duke i ofruar stafit kompetencë përmes certifikatës për trajnimin e ndjekur;*
- *Stafi trajnues/arsimor të shqyrtojnë fokusimin e përmbajtjeve programore edhe në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të pjesëmarrësve në programet arsimore dhe trajnuese në AKSP;*
- *Të rritet numri i bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare në theks të veçantë shkëmbimit të përvojave në fushën e mësimit online;*
- *Të shqyrtohet mundësia e riaranzhimit të orarit të programeve arsimore sidomos në atë teorik duke mundësuar që mësimi online të jetësohet dhe avancohet tutje, disa nga programet trajnuese që në thelb janë teori, të kalojnë plotësisht në sistemin online me mundësi të modifikimi të orëve teorike;*
- *Shqyrtimin e mundësive të krijimit të bazës së të dhënave nga fusha e formatit video e cila do asistonte aspektin praktik të mësimit;*
- *AKSP të shqyrtoj mundësinë e ngritjes së kapaciteteve dhe shërbimeve që ofrohen nga njëësia e multimediate sidomos në aspektin e burimeve profesionale në numër si dhe ato logjistike mbështetës të krijimit të dhomave multimediale, virtuale apo simulative të cilat do lehtësonin edhe internshipin-pjesën praktike;*